

L I G J
Nr.7771, datë 7.12.1993

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7748, DATË 29.7.1993 "PËR STATUSIN E ISH-TË
DËNUARVE DHE TË PËRNDJEKURVE POLITIKË NGA SISTEMI KOMUNIST"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 10 i ligjit nr.7748, date 29.7.1993 ndryshohet si vijon:

"Procesi i regjistrimeve për njohjen e të drejtës së statusit do të vazhdojë deri më 31.5.1994. Mbas këtij afati do të pranohen me kërkesa, përveç rasteve të pamundësisë së plotë të vërtetuar me vendim gjykate.

Neni 2

Në nenin 14 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Përfshihen nga të drejtat pasurore që përfitohen nga ky status, të gjithë personat e kategorizuar në shkronjën "e" të nenit 5 të këtij ligji".

Neni 3

Neni 17 ndryshohet si vijon:

"Të gjitha dokumentet e parashikuara në nenin 16 do të mblidhen nga degët e Komiteti të Ish-të Përndjekurve Politikë në rrethe dhe rajonet për Tiranën, të cilat do t'ia përcjellin Komitetit të ish-të Përndjekurve Politikë, që i përgatit dhe ia paraqet për shqyrtim Komisionit shtetëror trepalësh".

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.716, datë 17.12.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.